



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
Agjencia për Barazi Gjinore / Agencija za Ravnopravnost Polova / Agency of Gender Equality

BULETINI
INFORMATIV

| 2016





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/

AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV

2016

PËRMBAJTJA

• INICIATIVAT E AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE

U lansua Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve	5
Prezantohet Ligji për Barazi Gjinore	7
Ka filluar punën grupi për vlersimin e EX-Postit.....	7
Mbahen punëtorit rajonale për Procedurat Standarde të Veprimit.....	7
Miratohet Rregullorja për detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna	8

• MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES ABGJ-SË DHE SIDA- SUEDEZE

ABGJ ka mbajt punëtorinë për përgatitjen e planit katërvjeçar të projektit.....	9
---	---

• AKTIVITETET AVOKUESE

Shënimi i 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas	10
25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas - 16 Ditët e Aktivizmit.....	10
Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore	11

• BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET RELEVANTE

Mbahet Konferenca me temë "Konsultime të Nivelit të Lartë rreth Procesit të Integrimit Evropian dhe Barazisë Gjinore "	13
Mbahet trajnimi - Integrimin Gjinor në Planifikim Hapësinor	13
Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur takimin Koordinues me Donator	14
ABGJ ka mbajt takimin e radhës me Zyrtare për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna	14
ABGJ në bashkëpunim me OSBE-në, mbajti tryezen me temë "Të gjeturat nga Monitorimi dhe Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore 2015"	14
U nënshkrua Memorandum mirëkuptimi në mes Agjencisë për Barazi Gjinore dhe OJQ-së POLIS Lipjan	15

• AKTIVITETET E ZYRTAREVE PËR BARAZI GJINORE NË MINISTRI DHE KOMUNA

16



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / / OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/

AGENCY OF GENDER EQUALITY

Agjencia për Barazi Gjinore institucion i mandatuar për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore 05/L-020, ka punuar me përkushtim në avancimi e agjendës për barazi gjinore gjatë vitit 2016, dhe dallojmë disa veprime me të cilat kemi përplotësuar kornizën ligjore dhe kemi përmbushur obligimet e dala nga ligji.

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale, i propozuan Qeverisë në fillim të vitit 2016 miratimin e një mase afirmative: "Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët, në Emër të Dy Bashkëshortëve, pa pagesë", Qeveria e miratoi këtë iniciativë duke e parë si fakt të domosdoshëm inkurajimin e çifteve që nga fillimi i krijimit të pronës, ta gëzojnë të drejtën regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve, e drejtë kjo e garantuar edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dhe i tërë legjislacioni në fuqi por e cila në praktikë rrallëherë zbatohet në emër të të dy bashkëshortëve. Dy agjencitë shtetërore të cilat e kanë propozuar këtë masë afirmative kanë promovuar masën afirmative gjatë gjithë vitit, dhe kanë ofruar këshilla për zbatimin e sajë, si dhe kemi ofruar informacione mbi progresin apo pengesat e cilat duhet eliminuar, në mënyrë që të vlerësojmë se si funksionojnë mekanizmat institucional ndaj kërkesave të qytetarëve pa dallim gjinie kur është në pyetje prona dhe qasja në të.

Përgjatë vitit 2016 ABGJ ka vazhduar me promovimin e Ligjit të amandamentuar në vitin 2015, pasi që ky përplotësim solli risi dhe obligime të reja për institucionet e Republikës së Kosovës. Ky Ligj obligon institucionet e Kosovës të ndërmarrin hapa shtesë në lidhje me integrimin gjinor, buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Ligji i ri ka rishikuar të kuptuarit e barazisë gjinore dhe ky Ligj vendos pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe burrave në masën 50% duke i bërë thirrje institucioneve që të marrin masa të përgjithshme dhe të veçanta në mënyrë që të punojnë drejt këtë qëllim.

Rolet e institucioneve përgjegjëse për sigurimin dhe promovimin e barazisë gjinore janë gjithashtu sqaruar më tej në kuadër të ligjit të ri. Gjatë vitit 2016 është miratuar: Rregullorja Nr.12/2016 për detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përkatës për barazi gjinore në ministri dhe komuna, e cila qartëson rolin e këtyre mekanizmave brenda institucioneve ku ato veprojnë.

Një arritur e Agjencisë për Barazi Gjinore gjatë vitit 2016 ka qenë prezantimi i raportit final të zbatimit të PV për zbatimin e Rezolutës 1325 (2013-2015) "Gratë paqja dhe Siguria" Me këtë plan veprimi Kosova ka hyre në mesin e 60-të shteteve të botës, që kishin zhvilluar plane të veprimit për zbatimin e kësaj rezolute. Dhe ky plan i veprimit u realizua në masën prej 79 për qind

, edhe pse në përfundim të planit ende nuk ishte themeluar Komisioni për verifikimin e statutit të mbijetuarave të dhunës seksuale, angazhimi vazhdoi dhe arritëm që përkundër përfundimit të Planit të Veprimit komisioni të themelohej, sepse praktikat që hyjnë në funksion përmes politikave të reja nuk mbarojnë së funksionuar me përfundimin këtyre politikave sipas afateve kohore, por ne kemi punuar për institucionalizimin e tyre të mëtutjeshëm dhe vendosjen e tyre në sistemin institucional dhe kjo është ajo që kemi synuar mbi të gjitha, pasi që asnjë politikë sado e avancuar të jetë nuk ka asnjë vlerë nëse arritjet nuk përkthehen në veprime të përditshme të cilat kanë synimin të ndryshojnë sjelljet dhe qëndrimin e njerëzve. Duke shprehur respektin dhe konsideratën me të lartë për të gjithë bashkëpunëtorët/et të cilët punuan dhe bashkëpunuan në ngritjen e nivelit të diskutimit dhe të trajtimit të kësaj problematike, dhe sidomos angazhimin e Presidentes Jahjaga, ky plan veprimi dha një kontribut modest në ndryshimin e mendësisë dhe qasjes ndaj të mbijetuarve.

Agjencia vazhdon të insistoj që me angazhimin e saj të ngritë nivelin e përfshirjes së perspektivën gjinore jo vetëm në politika publike, por ta kthejë në mënyrë menduarit institucional gjithë përfshirjen. Përfshirja e grave dhe vajzave në vendimmarrje duhet të jetë prioritet dhe pjesëmarrja dhe kontributi i tyre nuk vlen për përfaqësim numerik, por është kontribut cilësor e shoqëror në krijimin e një realiteti të ri në Kosovë që bazohet në barazinë mes dy gjinive dhe të një shoqërie në harmoni me vetveten.

Faleminderit,

EDI GUSIA

**KRYESHEFE EKZEKUTIVE
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE
ZYRA E KRYEMINISTRIT**

Lansohet Udhëzimi Administrativ për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshortëve



Foto nga lansimi i UA për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës lansoj "Udhëzimin Administrativ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve", të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Mars 2016.


E drejta në pronë, është një e drejtë themelore që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit, si dhe nëpërmjet ligjeve në fuqi si: Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Familjen, Ligji i Trashëgimisë, Ligji mbi Pronën dhe Ligji kundër Diskriminim.

Një vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Barazi Gjinore, kjo është masa e parë afirmative e miratuar nga Qeveria e Kosovës e cila duhet vlerësuar si një masë tepër e veçantë në nxitjen dhe zbatimin e Barazisë Gjinore në Kosovë.



Në këtë takim të pranishëm

ishin Kryeministëri i Republikës së Kosovës Isa Mustafa, Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edi Gusia, Drejtori i Misionit të USAID në Kosovë James Hope dhe pjesëmarrës nga Institucionet e Kosovës dhe Shoqëria civile.

Në fund u shfaqe videoklipit i realizuar nga ABGJ me mbështetje nga USAID i cili u transmetua në Televizionin Publik RTK për "Udhëzimin Administrativ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve".



Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve



Udhëzimi Administrativ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve

Prezantohet Ligji për Barazi Gjinore



Foto nga prezantimi i LBGJ

Agjencia për Barazi Gjinore gjatë vitit 2016, ka vazhduar me prezantimin e dispozitave të reja të Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar një vit më parë.

Gjatë takimeve të mbajtura për prezantimin e

LBGJ është diskutuar edhe për fuqizimin dhe bashkëpunimin mes mekanizmave komunalë për komunitete dhe zyrtarëve për barazi gjinore. Tryezat janë mbajtur në këto rajone : Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjiçani dhe Prishtinë.

Në këto tryeza kanë qenë të përfshirë përfaqësuesit e këshillave të komuniteteve, përfaqësuesit e zyrave për komunitete dhe kthim, zëvendës kryetaret e komunave për çështje të komuniteteve, zëvendës kryesuesit e kuvendit komunal për komunitete.

Aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me Misionin në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Prezantimet i ndoqën rreth 590 pjesëmarrës.

Ka filluar punën grupi për vlersimin e EX-Postit

Agjencia për Barazi Gjinore /Zyra e Kryeministrit ka filluar procesin e vlerësimit të Ex-Post- it, të Ligjit 05/L-020 për Barazi Gjinore (G.Z. e Republikës së Kosovës /nr 16, 26 qershor 2015).

Vlerësimi i Ex-postit do të përfshijë dispozitat si: Masat e veçanta, kuotat, statistikën e ndara në gjini dhe buxhetimin gjinor.

Me këtë rast është mbledhur grupi punues dhe janë specifikuar tre objektiva të përgjithshme, shtatë të veçanta dhe veprimet që do të ndërmerren në vazhdimësi.

Grupi i punës do të vazhdojë të punojë sipas afatit të paraparë ligjor dhe do t'i përmbahet udhërrëfyesit për vlerësimin EX-post të legjisllacionit në Republikën e Kosovës.



Foto nga grupi punues për vlerësimin e Ex-postit

Mbahen punëtorit për Procedurat Standarde të Veprimit

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë dhe në mbështetjen me OSBE-në, me datë 08 shtator 2016 organizuan punëtorin për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit për

mbrojtjen nga dhuna në familje në Komunën e Ferizajt.

Pjesëmarrja ishte gjithëpërfshirëse: profesionist shëndetësor, mjekë/e, infermierë/e dhe psikologë nga QKMF, QMF, AMF në Ferizajt, Viti, Kaçanik, Hani Elezit, gjithsejtë 43 pjesëmarrës.

Janë prezantuar Procedurat Standarde të Veprimit (më tej PSV) për mbrojtje nga dhuna në familje respektivisht obligimet e profesionistëve shëndetësorë në rastet

e trajtimit, lajmërimit dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Rekomandimet nga Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit dhe nga Ministria e Shëndetësisë për pjesëmarrësit ishin:

- Institucionet shëndetësore ti përmbahen obligimeve të përcaktuara në PSV,
- Të mbahet regjistër i veçante për dhunën në familje, dhe të mbahet dokumentacioni formulari në çdo tavolinë të profesionistëve shëndetësor
- Nëse kanë raste të dhunës në familje të identifikohen, të jepen shërbimet shëndetësore me fokus tek referimin, mbrojtja dhe rehabilitimin dhe integrimi, dhe të plotësohen dhe të ruhen si dokumentacion i veçante gjithë profesionistët shëndetësor.

Me datë 20 tetor 2016, ABGJ në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë dhe në mbështetjen me OSBE mbajtën training me temë Mbështetja e sistemit ligjor për të qenë gjithnjë në përputhje me standardet ndërkombetare".

Pjesëmarrës në punëtori ishin Stafit Shëndetësor i komunës së Gjilanit dhe regjionit me strukturë ndëretnike, ku u njoftuan me kornizën ligjore kundër dhunës në familje dhe qartësimin e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve në identifikimin, ndihmën që duhet dhënë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në Policinë e Kosovës dhe në Qendrën për Punë Sociale. Fokus të veçantë mori mbajtja/evidenca e protokollit shëndetësorë si dhe mbajtja e data bazës në lidhje me rastet e dhunës në familje. Në këtë punëtori morën pjesë 48 pjesëmarrës.

Prezantimi i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje me datë 05 dhjetor 2016 u mbajtën në komunën e Gjakovës, ku morën pjesë 43 personat të stafit shëndetësor.

Ndërsa, me datë 09 dhjetor 2016 prezantimi i PSV u mbajt në komunën e Klinës, ku pjesëmarrësit ishin nxënës të shkollave të mesme, drejtore/zëvendës drejtor të shkollave, personel arsimor, këshilltar/e komunale, shërbyes civil komunal, gjyqësori, shoqëria civile etj. Në këtë komunë ishin prezent 80 pjesëmarrës.

Miratohet Rregullorja për detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Agjencia për Barazi Gjinore hartoi rregulloren për detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna, e cila u miratua nga Qeveria e RKS me vendimin nr. 12/2016. Me miratimin e saj ABGJ realizoi obligimin e dalë nga Ligji për Barazi Gjinore i amendamentuar në 2015. Kjo rregullore ka për qëllim përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të ZBGJ, linjën e raportimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore dhe zyrtarëve përkatës për barazi gjinore në Ministri dhe Komuna. Zyrtarët/et për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna përfaqësojnë mekanizma të kualifikuar institucionalë për koordinimin, zbatimin, integrimin, monitorimin dhe promovimin e barazisë gjinore, në të gjitha nivelet e qeverisjes institucionale dhe politikave publike të Republikës së Kosovës. Në Komuna ZBGJ do të sigurojnë këshilla profesionale Kryetarëve të Komunave në formulimin e politikave pro-gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore në dokumente strategjike dhe plan programe etj. Në Ministri ZBGJ po ashtu siguron rekomandime dhe këshilla profesionale për Udhëheqësin e më të Lartë Administrative në formulimin e politikave gjinore dhe integrimin e komponentit gjinore në dokumente strategjike etj.

Procesi i hartimit të kësaj rregulloreje u mbështet nga GIZ.

Linku i web faqes <https://abgj.rks-gov.net//>

ABGJ ka mbajt punëtorinë për përgatitjen e planit katërvjeçar të projektit



Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Projektin për "Fuqizimin Institucional për ABGJ-në dhe mekanizmat gjinorë në Kosovë", të financuar nga Qeveria Suedeze – Sida, zhvilloji në Prizren prej datës 26-të deri me 30-të shtator ka mbajtur punëtorinë për përgatitjen e planit katërvjeçar të projektit për mbështetje institucionale të ABGJ dhe rrjetit të zyrtareve për barazi gjinore, dhe institucioneve të Kosovës për avancimin e Barazisë Gjinore në Kosovë.

Në këtë punëtori e cila është mbajtur për katër ditë radhazi, kanë qenë të përfshirë gjithësej tridhjetë (30) persona: Zyrtarë nga Agjencia për Barazi Gjinore, ZBGJ nga niveli qendror dhe lokal, si dhe zyrtarë të tjerë nga institucione të ndryshme. Projekti drejtohet nga konsorciumi i përbërë nga Niras /Indevelop, DADA6 and. Gjatë trajnimit, u zbatuan metoda e planifikimit të menaxhimit të bazuar në rezultate si dhe konceptet e integritit gjinor, krahas atyre të planifikimit strategjik të integruar.

Punëtorja u drejtua nga nga Udhëheqësja e Projektit, znj. Blerinda Idrizi.

Shënimi i 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, kanë shënuar 8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me seminarin "Roli dhe Pozita e femrës në Kosovë".

Seminari kishte si qëllim të mbledhë së bashku të gjithë akterët që ofrojnë mbështetje për gratë dhe vajzat, me qëllim të shqyrtimit

të opsioneve dhe nxjerrjen e rekomandimeve konkrete se si të orientohen politikat shtetërore drejt një fuqizimi të femrës në Kosovë.

Në sesionin e parë u diskutuan temat si: **Pjesëmarrja e femrave në Arsimin e Lartë Prona dhe Trashëgimia e prones nga femrat Legjislacioni Kundër Dhunës në familje**

Ndërsa, në sesionin e dytë u diskutua për: **Femrat pronare të pyjeve Përfshirja e Femrave në Vendimarrje Fuqizimi Ekonomik i Grave**

25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas - 16 Ditët e Aktivizmit



Foto nga shënimi i 16 Ditëve të Aktivizmit

ABGJ ka shënuar tradicionalisht 25 Nëntorin, **"Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas"**, me mbajtjen e një tryeze diskutimi, ku është prezantuar raporti i dytë Monitorues për Progresin e Implementimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria".

Të pranishëm në këtë tryzë ishin Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale zt. Arban Abrashi, Ud. Kyeshefja Ekzekutive e ABGJ znj.

Edi Gusia, Deputete e Kuvendit të Kosovës, Përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare, Shoqëri Civile etj.

Në kuadër të kësaj fushate ABGJ ka vazhduar edhe me aktivitete të ndryshme, realizimi i një videoklipi i cili është transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës, materjale promovuese dhe vendosja e pesë billbordëve në qytete, me moton: **"Angazhohu edhe ti kundër dhunës ndaj grave"**.



Aktivitetet të realizuara në kuadër të
16 Ditët e Aktivizmit

Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, Udhëzimit Administrativ Nr 01/02/2012 për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore si dhe mandatit të saj, Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë subvencionimin e pjesshëm të projekteve të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, dhe fuqizimin ekonomik të tyre.

Gjatë vitit 2016 Agjencia për Barazi Gjinore ka mbështetur personat fizik dhe personat juridik të cilët janë aktiv në fushën e barazisë gjinore.

Pra, gjithsejtë janë përzgjedhë dymbëdhjetë projekte që i kanë plotësuar kushtet dhe specifikat e parapara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2012.



ABGJ ka subvencionuar projektin e OJQ "Artpolis" i cili projekt ka pas qëllim organizmin e Festivalit për të drejtat te njeriut –Edicioni 4".

Gjatë këtyre ditëve sa ka zgjatur Festivali FEMART, janë mbajtur rreth 30 aktivitete me mbi 100 artiste/artistë dhe aktiviste, në 8 Lokacione të ndryshme në Prishtinë, Artpolis ka mundësuar sjelljen e artit origjinal të krijuar dhe prezantuar nga artistet duke përfshirë: Shfaqje Teatrale, Filma dokumentar dhe të shkurtër, Punëtori, Ekspozita, Performancë, Promovim Libri, Poezi, Muzikë, Panele Diskutimi, Koncerte, Punëtori dhe forma të tjera të artit të krijuara nga artistet dhe aktivistet nga: Kosova, Rajoni dhe Europa. ABGJ ka financuar një pjesë të materialit të marketingut.

Me qëllim të fuqizimit ekonomik të gruasë ABGJ, ka financuar projektin me temë "Avancimi i gruas në Vendimmarrje dhe plotësimi i kushteve ekonomike", të kopshtit për fëmijë të "OJQ-Babezi", me këtë rast është ndihmuar në rregullimin e oborrit, vendosjen e plakave të gomës, si dhe vendosjen e kamervave në çerdhe. ABGJ ka përkrahur projektin për "Blerjen e nje kopeje dhishë" të personit fizik, duke i mundësuar në ngritjen dhe mirëqenien e familjes.

Me qëllim që të rritet dhe të fuqizohet roli i gruas në shoqëri, ABGJ ka mbështetur projektin "Pune dore dhe prodhim i veshjeve te jashtme", me blerjen e një makine qepëse.



Me qëllimi të rritjes së vetëdijesimi të grave ndaj dhunës, ngacmimit seksual, fuqizimit ekonomik, e drejta pronsore, roli në krijimin e familjes, edukimi dhe rintegrim, ABGJ ka financuar projektin e N.SH."FLATRA" me titull "*Informimi dhe vetëdijesimi i grave*" përmes kësaj reviste janë publikur artikuj, ku preken të gjitha temat lartpërmendura.

ABGJ ka bërë subvencionimin e pjesëshëm "*Nota cake*" për projektin "*Torte me Porosi*" projekti ka pasë si qëllim fuqizimin dhe zhvillimin e biznesit duke përkrahur dhe zhvilluar veprimtarin për prodhimin e tortave duke financuar një pjesë të mjeteve për blerjen e furrës me rrymë.

ABGJ ka përkrahur projektin "*Rregullimi lokalit dhe pajisje për rrobaqepësi*" të personit fizik qe si qëllim kishte funksionalizimin e lokalit për të ushtruar në kushte më të mira profesionin e rrobaqepësisë. Rezultati i realizimit të këtij projekti ishte ngjyrosja e mureve dhe vendosja e kablove të rrymës dhe funksionalizimi i lokalit i cili e ndihmoi në ngritje dhe fuqizimin ekonomik.

Me qëllim të trajnimit dhe fuqizimit të shoqatave dhe të gruas në ekonomi, ABGJ ka financuar projektin e OJQ"Fatjona" me teme "*Fuqizimi i grave ne vise rurale*" qëllimi i këtij projekti ishte që të organizojë më shumë gra rreth shoqatës dhe qëllimi tjetër ishte që shoqata të krijoj biznes të qendrushme për prodhimin e tekstilit .Rezultate e projektit janë blerja

e materialeve të nevojshme dhe rindertimi i objektit.

ABGJ me qëllim të fuqizimit të ekonomive familjare ka financuar projektin "*Rritja dhe kultivimi i bletëve*". Ku me këtë rast u mundësua blerja e pajisjeve modern për aktivitet të vjeljes së mjaltit.

ABGJ ka përkrahur projektin "*Fushtë informuese për të drejtën pronsore dhe të drejtën në trashëgimi*", ku ka ndihmuar në shtypjen e 1000 broshurave informuese. Qëllimi i subvencionimit të projektit të OJQ Zana ishte mbajtja e takimeve me grupe të interesit me qëllim të informimit të bashkëshortëve për trashëgimi pronësore, si dhe njoftimi me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ 03/2016 për masat e vecanta për regjistrimin e pronës ne emër të dy bashkëshortëve.

ABGJ ka financuar projektin "*Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës seksuale*" të OJQ – QPDG. Synimi i projektit ishte fuqizimi i grave përmes angazhimit të 10 viktimave të dhunës seksuale të cilat janë trajnuar për rrobaqepesi. Më këtë rast është ndihmuar me blerja e materialeve të domosdoshme për trajnim.

ABGJ po ashtu, ka përkrahur projektin "*Rritja dhe Kultivimi i Bletëve*" në blerja e koshereve për bletë, qe si qëllimi i projektit ishte ngritja e mirëqenies famailjare.

Mbahet Konferenca me temë "Konsultime të Nivelit të Lartë rreth Procesit të Integrimit Evropian dhe Barazisë Gjinore"

Ministria e Integritimeve Evropiane në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, kanë organizuar Konferencën me temë "Konsultime të Nivelit të Lartë rreth Procesit të Integrimit Evropian dhe Barazisë Gjinore".

Qëllimi i organizimit të kësaj konference ishte që të ketë një diskutim të hapur dhe thelbësor me akterët përkatës dhe se si shoqëri mund të avancojmë barazinë gjinore në Kosovë, duke punuar së bashku me shoqërinë civile në kuadër të procesit të integrimit evropian, në veçanti në procesin e zbatimit të MSA-së.

Në hapje të Konferencës Ministri për Integritim Evropian, Bekim Çollaku pasi falënderoi pjesëmarrësit, theksoi se prezenca e femrave në institucione, sidomos në Ministrinë e Integritimeve ka treguar se femrat janë shumë të zonja dhe kompetente për punët që i kryejnë, madje më të përgjegjshme se meshkujt. Sipas tij, si shoqëri duhet të punohet edhe më shumë që të transformojmë shoqërinë dhe ta përafrojmë me strukturat e EU. Çështja e Barazisë Gjinore nuk duhet të trajtohet si kusht për integritim në EU, por si domosdoshmëri për zhvillim të kësaj shoqërie.

Ndërkaq, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës foli Kryeministri i Republikës së Kosovës Isa Mustafa i cili tha se takimi i sotëm është i një rëndësie të veçantë, pasi që kemi rastin të bisedojmë për këto çështje, të cilat unë konsideroj se nuk i përkasin vetëm integrimit tonë evropian dhe vetëm agjendës sonë evropiane, por janë të ndërlidhura ngushtë edhe me agjendën tonë kosovare, sepse dëshirojmë që të themelojmë dhe të ndërtojmë një shtet, i cili ka vlera të demokracisë së brendshme, ka vlera të barazisë gjinore dhe vlera të barazisë nacionale dhe në të cilin vend, të gjithë qytetarët do të ndjeheshin të barabartë pa marrë parasysh dallimeve të tyre gjinore, etnike ose dallimeve sociale.

U.d Kryeshefja Ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore Edi Gusia, në fund të takimit prezantoi rekomandimet dhe pritjet e ABGJ sa

i përket çështjeve që u diskutuan gjatë takimit, të cilat janë si vijon:

- Krijimi praktikës institucionale të bashkëpunimit mes mekanizmave për integritime evropiane dhe barazi gjinore në nivel vendi, në planifikimin dhe zbatimin e asistencës së BE
- Rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në jetën institucionale përmes ndërmarrjes së veprimeve të përshpejtuara të qëndrueshme apo edhe atyre të përkohshme, siç janë masat afirmative
- Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor i përcjellë me statistika të ndara në baza gjinore
- Zbatimi i politikave të kombinuara si ato të parapara në strategjinë kombëtare për zhvillim për ta rritur nivelin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës
- Dhe përfundimisht monitorimin e politikave publike me indikatorë gjinor, që lehtëson përcjelljen e progresit dhe adresimin e problemeve dhe hartimin e politikave publike me bazë gjinore që kontribuojnë zhvillimin dhe krijimin e një shoqërie harmonike dhe të barabartë, dhe që sigurojnë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe qëndrueshmërinë e proceseve të zhvillimit socio ekonomik, politik dhe paqes në Kosovë dhe rajon.

Mbahet trajnimi - Integritimin Gjinor në Planifikim Hapësinor

Agjencia për Barazi Gjinore në partneritet me Un Women dhe Programin për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP) ka mbajtur trajnim me temë "Integritimin Gjinor në Planifikim Hapësinor".

Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë ti ofroj pjesëmarrësve këshilla mbi integritimin gjinor, marrëdhëniet gjinore, në lidhje me hapësirën dhe planifikimin zhvillimor hapësinor. Një planifikim hapësinor me perspektivë gjinore, nënkupton standarde që iu garantojnë grave dhe vajzave siguri personale, qasje të duhura në hapësirat publike, lëvizshmëri, strehim si dhe shërbime të ndryshme publike.

Ky trajnim është mbajtur tri ditë radhazi, ku kanë qenë të përfshirë gjithsejtë gjashtëdhjetë (60) Zyrtarë nga Agjencia për Barazi Gjinore, ZBGJ nga niveli qendror dhe lokal, si dhe zyrtar tjerë nga institucione të ndryshme. Në fund për të gjithë pjesëmarrësit janë ndarë certifikata.

Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur takimi Koordinues me Donator



Foto e realizuar nga takimi me donator

Në takimin koordinues cili u organizua në prill të 2016 në mes të ABGJ-së dhe donatorve është bërë prezantimi i aktiviteteve në fushën e Barazisë Gjinore të cilat janë planifikuar të zhvilloheshin gjatë viti 2016, duke përfshirë këtu edhe prezantimin e aktiviteteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me zyrtaret për barazi gjinore në nivel qendro dhe lokal.

Në këtë takim drejtuesit e ABGJ-së kanë prezantuar planet dhe prioritetet për këtë vit në fushën e Barazisë Gjinore. Po ashtu, gjatë takimit u bë prezantimin i raportit "Përfshirja e çështjes gjinore në politikën dhe strategjitë për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore", të realizuar nga UNDP. Ndërkaq, pjesëmarrësit tjerë vlerësuan se nevojitet që të ketë një koordinim sa më efikas të të gjithë akterëve, dhe bashkërisht të vendosen prioritetet në fushën e barazisë gjinore, në mënyrë që të ketë suksese më të mëdha sa i përket realizimit të projekteve të përbashkëta. Në takimi ishin prezent edhe donatorët nga **USAID-Un Women, GIZ, OSBE , Helvetas, Un- Habitat dhe RRGK.**

ABGJ ka mbajtur takimin e radhës me Zyrtare për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Agjencia për Barazi Gjinore, ka organizuar takimin e radhës me Zyrtare për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna. Gjatë takimit janë prezantuar aktivitete të cilat janë përfunduar deri tash dhe planet të cilat priten që në fund të këtij viti kalendrik të realizohen nga ana e ABGJ-së.

Ndër të tjera gjatë takimit u prezantua edhe Rregullorja e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Komuna dhe Ministri e cila është aprovuar nga qeveria e Republikës së Kosovës.

Në fund të takimit u diskutua lidhur me koordinimin dhe bashkëpunimin e aktiviteteve të cilat janë planifikuar nga ABGJ dhe nga zyrtaret për Barazi Gjinore në Komuna dhe Ministri që në këtë vit të shenohen 16 ditët e aktivizmit.

ABGJ në bashkëpunim me OSBE-në, mbajti tryezen me temë "Të gjeturat nga Monitorimi dhe Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore 2015"

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Misionin për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) me datë 8 nëntor 2016 ka mbajtur tryezë të rrumbullakët në komunën e Gjilanit.

Gjatë takimit u prezantuan të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinor në këtë komunë si dhe u ndanë opinione rreth zbatimit të tij nga zyrtaret komunal dhe përfaqësues të tjerë.

U nënshkrua Memorandum mirëkuptimi në mes Agjencisë për Barazi Gjinore dhe OJQ-së POLIS Lipjan

Agjencia për Barazi Gjinore ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me OJQ-ë Polis Lipjan, për Implementimin e Projektit: **"Angazhimi i përbashkët për të drejtat e grave në pronë të përbashkët"** për regjionin e Prishtinës dhe të Ferizajit, dhe angazhimin e përbashkët për avancimin e të drejtave të grave në Kosovë.

Synimi i përgjithshëm i këtij projekti konsiston në vetë informimin e grave në të drejtën e tyre në pronë, ndërgjegjësimi institucional, si dhe vetëdijësimin qytetarë ku grua jo vetëm që do të njihet me të drejtën e saj në pronë, por do të përkrahet pakursyeshëm për të realizuar të drejtën e saj ligjore si pronare e përbashkët. Po ashtu kjo Organizatë ka publikuar një hulumtim mbi Të drejtën

e Grave në Pronë" ku kishte si qëllim prezantimin e opinionit të një shtrese të caktuar të shoqërisë, sikur janë zyrtarët e ndryshëm që veprojnë në nivelin lokal, e që në një formë janë të lidhur me çështjet dhe të drejtat pronësore në Kosovë. Pjesë tjetër e veçant e këtij raporti është edhe vlerësimi apo matja e nivelit të zbatimit të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve të miratuar nga Qeveria e Kosovës në mars të vitit 2016. Si dhe në fund të ofroj disa përfundime të bazuara rreth gjendjes së të drejtave të grave në pronë, rekomandime eventuale që mund të shpiejnë në një avancim të të drejtave dhe pozitës së grave në pronë.



Foto e realizuar nga nënshkrimi i marrëveshjes ABGJ dhe OJQ Polis

Aktivitete e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë gjatë periudhës 2016 ka organizuar një varg aktivitete në sferën e të drejtave të barazisë gjinore. Karshi këtyre aktiviteteve MASHT-i si dhe herëve tjera ishte pjesë për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Vajzave, e cila shënohet në tërë botën nga OKB, ku tema ishte **Fuqia e Vajzës (Vajzave) adoleshente: Vizioni për vitin 2030.**

Po ashtu në kadër të kësaj date është mbajtur tryezë e rrumbullakët e udhëhequr nga zv. Ministrja Anila Statovci, Dema e cila foli për rolin dhe rëndësinë e arsimit, edukimit të femrës (vajzave dhe grave) si dhe angazhimet e saj në të gjitha sferat e jetës.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, MASHT

Pra, shënimi i kësaj dite sjell më shumë vëmendje jetën e vajzave dhe grave si qytetare dhe zëra të fuqishëm që bëjnë ndryshime në familjet dhe komunitet. Kjo ditë ndërkombëtare promovon trajtimin e barabartë dhe mundësitë për vajzat në mbarë botën në fusha të tilla, si ligji, kujdesi shëndetësor, arsimimi si dhe lirinë nga dhuna dhe abuzimi.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, MIE



Aktiviteti i ZBGJ në MFSK

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Mministrin e Integritimeve, në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas - 25 Nëntori, ka organizuar një takim në mes të Zv. Ministres Anila Statovci-Demaj dhe "Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave" në Drenas të udhëhequr nga znj. Kadire Tahiraj.

Zv.Ministrja Statovci-Demaj u njoftua në detaje për punën e qendrës dhe për misionin e saj i cili është përmisimi i të drejtave njerëzore të gruas, sidomos ato që kanë përjetuar trauma gjatë luftës, duke i ofruar ndihmë të drejtpërdrejt, rehabilitim, mirëqenie, aktivitete të ndryshme, duke u munduar që sado pak të ndryshohet jeta dhe përditshmëria e tyre. Me këtë rast Zëvendës Ministrja Statovci-Demaj shprehi gatishmërinë për të ndihmuar Qendrën për Promovimin e Drejtave të Grave dhe i përgëzoi për punën që kjo qendër bënë në vazhdimësi në përmisimin e nevojave dhe të drejtave të tyre, me këtë rast ka ofruar një donacion me vlerë 1000 mijë euro (një mijë euro) për blerjen karrigve dhe tavolina për nevojat e tyre.

Gjithashtu MIE ne bashkëpunim me Komisionin Evropian ndajnë bursa për studentet e Republikës së Kosovës ku për vitin kalendarik 2015-2016 janë pranuar gjithsej 35 studente nga të cilët 16 kanë qene 19 Femra (3 femra kanë qene të minoriteteve) dhe 16 Meshkuj.

Ndërsa sa i përket subvencioneve që ndahen nga MIE për vitin 2016 janë ndarë gjithsej 43 OJQ/persona fizik ku prej tyre 18 kanë qene femra si dhe 25 Meshkuj.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me Qendrën e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) me seli Zvicër ka organizuar tryeze të rrumbullakët me temë "Mbështetje për gratë në uniformë - Promovimi i barazisë gjinore në zhvillimin e karrierës"

Në këtë tryezë pjesëmarrëse ishin përfaqësuesit nga shtete të ndryshme si: Zvicra, Holanda, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, përfaqësueset e DCAF-it, përfaqësuese të ambasadave të ndryshme në Kosovë, deputet të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së të Kuvendit të Kosovës, deputetë të Komisionit për të Drejtat të Njeriut dhe Barazi Gjinore në Kuvendin e Kosovës, përfaqësues nga Policia e Kosovës, OJQ, Avokati i Popullit si dhe oficerë dhe oficeret e FSK-së, zyrtarë të larta të MFSK-së, Përfaqësuese të Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s në MFSK si dhe të ftuar të tjerë.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) është e përkushtuar për ta mbështetur përparimin e grave në karrierë në MFSK dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), prandaj ka shtruar në këtë tryezë një dialog të gjerë në nivel ekspertësh ndërmjet përfaqësuesve nga Ballkani Perëndimor me synim që të: 1-Krijoj të kuptuar të përbashkët të rëndësishme të avancimit të grave në karrierë për të arritur struktura të paanshme dhe efektive të sigurisë; 2-Identifikoj barrierat për avancimin e grave në karrierë në strukturat e sigurisë; 3-Identifikoj politika dhe praktika

që e mbështesin mbajtjen, promovimin dhe avancimin e grave; 4.-Identifikoj mënyra për parandalim identifikim dhe reagim më të mirë ndaj ngacmimit, diskriminimit dhe ngacmimit seksual të burrave dhe grave; 5.-Identifikoj strategji për ta rritur efektshmërinë e strukturave të brendshme gjinore dhe rrjeteve të grave në maksimum; 6.-Forcoj rrjetet profesionale ndërmjet njësive të barazisë gjinore në strukturat e sigurisë dhe ekspertëve të çështjeve gjinore në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashëpunim me RRGK me përkrahjen e USAID kanë prezantuar raportin "Buxheti për Mjedis më të Mirë", ky raport prezanton rezultatet dhe rekomandimet që janë arritur këtë vit drejt institucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinore në MMPH. Me këtë analizë gjithëpërfshirëse të buxhetit dhe rekomandimet që kanë dal nga ky raport do të identifikohen nevojat e ndryshimit për përfshirjen e buxhetimit gjinore në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen shpërndarjen dhe caktimin e burimeve financiare.

Ndërsa me 8 Mars është prezantuar Ligji për Barazi Gjinore qëllim kryesor kishte rritjen e njohurive të zyrtarëve të MMPH-se se ky Ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin

e të drejtave të barabarta të femrave dhe meshkujve, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre. Po ashtu janë mbajtur takime lidhur me prezantimin e buxhetimit gjinor.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrin e Tregëtisë dhe Industrisë, ka punuar sipas detyrave të përcaktuara në këshillëdhënie dhe monitorim të çështjeve të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore sipas Ligjit për barazi gjinore. Janë trajtuar çështjet e mundësive të barabarta dhe komunitetet. Ndër aktivitete e tjera që ka realizu ministria është edhe dokumenti i buxhetimit gjinor, ku janë publikuar gjendja buxhetore dhe shpenzimet në baza gjinore për periudhën 2014, 2015 dhe 2016, ku me iniciative të ZBGJ është organizuar edhe një tryezë për buxhetim gjinor.

Si çdo vit edhe kësaj radhe MTI ka shënuar "Javën globale të ndërmarrësisë-Gratë në ndërmarrësi". Që ambienti i të bërit biznes për gratë ndërmarrëse në Kosovë të jetë sa më i favorshëm, pasi që gratë ndërmarrëse konsiderohen si partnere shumë të rëndësishme në zhvillimin e sektorit privat dhe zhvillimit ekonomik të vendit. "Forumi Ekonomik i Gruas" është bërë anëtare me të drejta të plota në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE). Forumi i grave është i përbërë nga disa organizata të grave, më mbështetje të MTI-së, me qëllim që të bëhet pjesë e keshillit për zhvillim ekonomik.

Kjo tabelë paraqet përfitueset gra në projektin "Gratë në biznes"

Viti	Buxheti total i shërbimit/ subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Buxheti për gra
2014				
2015	2,149,90 euro	60	60	100%
2016	4,850.00 euro	60	60	100%

Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit për vitin 2016 ka realizuar disa aktivitete sa i përket mbështetjes dhe fuqizimit të femrës në tersi. Departamenti i Sportit për vitin 2016 një ndër politikat me prioritet për sportin e Kosovës ka hartuar politikën, Sporti për Femra.

Departamenti i Sportit pas aprovimit final të

kësaj politike në bazë të buxhetit të aprovuar për vitin 2016 ka ndarë një buxhet të veçantë për avancimin e femrave në sport, rreth 15% e totalit të kodit 801(kodi i subvencioneve). Departamenti i Sportit në kuadër të politikave programore të vitit 2016, për kundër që ka ndarë buxhet të veçantë për femrat

sipas politikës nr.1. më rreth 350.000.00 euro ka dizajnuar programe dhe mundësi të përfitimeve dhe në të gjitha politikat programore të Departamentit të Sportit.

Gjatë kësaj kohe nga DS janë mbuluar rreth 80 aktivitete të sportit të femrave duke filluar nga krijimi i klubeve të reja, krijimi i ligave të grup moshave të reja, krijimi i reprezentacioneve të kategorive të ndryshme, pjesëmarrja e klubeve të femrave në gara Ballkanike, Evropiane, Botërore si dhe për herë të parë pjesëmarrje në Olimpiadë.

Ndërsa sa i përket mbështetjes financiare për femrat dhe meshkujt në Departamentin e Kulturës gjatë vitit 2016 është siç vijon: **Divizioni i Promovimit** ka ndarë **23.800.00** euro mjete për **12** projekte prej të cilave **9** projekte me bartës meshkuj respektivisht **19.800.00** euro një projekt me bartës femër **-1000.00** euro dhe **2** projekte me bartës të përbashkëta **-3000.00** euro.

Divizioni i Promovimit –Diversiteti dhe dialogu kulturor/komunitete jo shumicë ka ndarë 108,930.00 euro për 68 projekte –prej të cilave për 21 projekte me bartës femra janë 32.700.00 euro për 3 projekte të përbashkëta 7,500.00 euro dhe për 44 projekte me bartës meshkuj 68.730.00 euro.

Divizioni i Promovimit Industria kreative ky Divizion për 13 projekte ka ndarë shumë 13.600.00 euro. Prej tyre për 11 projekte me bartës femra janë ndarë 10.100.00 euro ndërsa për 2 projekte me bartës meshkuj 3.500.00 euro.

Divizioni i promovimit /Diplomacia kulturore ka mbështetur realizimin e 11 projekteve ne shumë 27.000.00 euro. Prej tyre për 8 projekte me bartës meshkuj është ndarë shuma prej 18.000.00 euro dhe 3 projekte me bartës e femra shuma prej 9.000,00 euro.

Divizioni i Arteve skenike muzikore dhe pamore-ekspozitata ka mbështetur 22 projekte me shumë të gjithmbarshme 45.370,00 euro. Prej tyre 15 projekte me bartës meshkuj janë ndarë 33.300 euro, për 5 projekte me bartës femra 6.570 euro dhe për 2 projekte të përbashkëta 5.500.00 euro.

Divizioni i arteve Skenike muzikore dhe pamore-Teatër gjatë vitit 2016 ka mbështetur 32 projekte për të cilat ka ndarë shumë prej 185.500.00 euro. Respektivisht për 15 projekte me bartës meshkuj ka ndarë 54.500.00 euro dhe 7 projekte me bartës femra ne shumë 16,500 euro kurse për 10 projekte të përbashkëta janë ndarë 114.500.00 euro.

Divizioni i arteve skenike dhe muzikore dhe pamore –muzika ky divizion ka mbështetur 48 projekte kulturore me shumë të gjithmbarshme 133.150,00 euro. Prej tyre 17 projekte me bartës meshkuj me shumë 39.950.00 euro, 18 projekte me bartës e femra me shuma 63.900.00 dhe 11 projekte të përbashkëta me shumë 32.300.00 euro.

Divizioni i arteve skenike dhe muzikore dhe pamore-filmi ky divizion ka mbështetur 2 projekte me bartës femra në shumë 16.000,00 euro, 2 projekte tw përbashkëta me shumë 11.000,00 euro dhe 15 projekte me bartës meshkuj ne shuma 68.000,00 euro.

Divizioni i librit-bibliotekat ka përkrahur 16 projekte të përbashkëta me shumë 25.700 euro.

Divizioni i librit –Takimet letrare ky divizion ka mbështetur 27projekte me shumë të gjithëmbarshme 88.000,00 euro prej të cilave 2 projekte me bartës femra ne shumë : 3.500,00 dhe 3 projekte me bartës meshkuj ne shumë 10 000,00 euro si dhe 22 projekte të përbashkëta ne shumë 74.500,00 euro.

MKRS ne kuadër të konkursit për botimin librit për vitin 2016 ka mbështetur 34 tituj me shumë 35.250,00 euro prej të cilave 6 tituj me bartës femra me shumë :5.600,00 euro respektivisht 28 projekte me bartës meshkuj me buxhet 26.650,00 euro

Rrjedhimisht Departamenti i Kulturës për konkurse gjatë vitit 2016 ka ndarë gjithsej 816.300,00 euro. Nga kjo shumë për 159 projekte me bartës meshkuj janë ndarë 371.430,00 euro, kurse për 77 projekte me bartës femra janë ndarë 170.860,00 euro.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Ndërsa për 68 projekte të përbashkëta janë ndarë 2740.10,00 euro.

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Hanit të Elezit, në bashkëpunim me Drejtorin Komunal të Arsimit më gjatë 2016 ka organizuar ligjeratë me maturantë të shkollës së mesme "Dardania" në Han të Elezit, me qëllim që të rritet vetëdijesimi dhe parandalimi i dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore në Kosovë.

Gjithsej janë mbajtur katër orë mësimore me katër klasë, pjesëmarrës në keto ligjerata kanë qene rrethe 120 nxënse.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, Hani i Elezit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës, ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsin, me një vizitë në monumentet e trashëgimisë kulturore në Prizren në kuadër të projektit "Gratë në ndërtimin e paqes" i financuar nga Komuna e Mitrovicës dhe implementuar nga OJQ -Asociacioni i Grave për të Drejtat e Njeriut në Mitrovicë, pjesë e këtij projekti ishin gjithsej 30 gra të komunitetit shqiptar, boshnjak dhe serb nga kuvendet komunale dhe gra aktiviste të reja nga komuna e Mitrovicës jugore dhe nga Mitrovica veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviçi.

Po ashtu gjatë këtij viti në Komunën e Mitrovicës është realizuar edhe projekti "Gruaja dhe Paqebërja, mbështetur nga Kvinna till Kvinna, ndërsa i implementuar nga OJQ lokale "Asociacioni i Grave për të Drejtat e Njeriut në Mitrovicë" me gratë e komunitetit shqiptar dhe serb, asambleiste dhe aktiviste të reja të Komunës së Mitrovicës jugore dhe komunave të rajonit të Mitrovicës veriore. Në kuadër të këtij projekti u realizuan dy module: "Komunikimi dhe aktivizmi" dhe "Siguria Integruese".



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, Mitrovicë

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Dragashit, gjatë periudhës 2016 ka realizuar dy aktivitet, ku present ne keto dy aktivitet ishin dhe Grupi i Grave Deputete të Parlamentit të Republikës së Kosovës. Aktiviteti i parë ishte lanësimi i Mamografis Mobil në Komunën e Dragashit, derisa aktiviteti i dytë ishte takimi në mes të Grupt të Grave Deputete të Parlamenit të Republikës së Kosovës dhe Kryetarit të Komunes së Dragashit, Asmablisteve të Kuvendit Komunal dhe shoqëris civile. Qëllim i këtij takim ishte bashkëpunim ndërinstutucional të nivelit lokal dhe qëndrore, më qëllim të forcimit të bashkëpunimit në qeshtjet që kanë të bëjnë me Barazin Gjinore.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, Dragash

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit, në bashkëpunim me shoqatën Hendikos u shënuar, "Ditën Ndërkombëtare e PAK 3 Dhjetor 2016". Me këtë rast është organizuar një marsh senzibilizues në qytetin e Drenasit me moton „Sot është Dita jote, Ngrite Zërin". Shënimi i kësaj dita ka vazhduar me një tryezë të rrumbullakët në të cilën u

prezantua një dokumentar për shërbimet që ka ofruar Hendikosi gjatë vitit 2016 për PAK, si dhe u diskutua për prioritetet zhvillimore nga institucionet dhe shoqëria civile, në këtë mënyrë duke sjellë perspektivë më të madhe në mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, Drenas

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prishtinës, në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit me rastin e shënimit të 7 Marsit, kanë ndarë 15 mirënjohje për gra veterane të arsimit mbi moshën 80vjet. Ndërsa, me 12 maj ZBGJ ka organizuar fushatën me moton, "Dhuro gjak, shpëto jetë", duke sensibilizuar popullatën për rendësin e dhurimit të gjakut.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, Prishtinë

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit, gjatë periudhës 2016, ka punuar në drejtim të promovimit të Barazisë gjinore duke u bazuar në Planin komunal të veprimit 2015-2017, ku parashihet zbatimi i shumë objektivave që synojnë Promovimin dhe integrimin e perspektives gjinore në politikat komunale dhe gjitha sferat e jetës shoqërore. Gjitha aktivitetet dalin apo ndërlihen edhe me zbatimin e Rezolutës 1325.

Në këtë periudhë janë pranuar apo emruar në instiucionet arsimore 4 Drejtoreshe dhe 3 Zëvendës drejtoresha me çrast është ritur numri i përfaqësimit të femrave në pozita udhëheqëse. ZBGJ ka ligjëruar mbi çështjet e promovimit dhe zbatimit të Ligjit për Barazi gjinore si dhe Rezolutës 1325. Janë mbajtur takime me qëllim të promovimit të Pakos së ligjeve –Ligji mbi barazinë gjinore, Kundër diskriminimit si dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, si dhe tryeza diskutimi për promovimin e Udhëzimit Administrativ mbi rregjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortvetë. Si cdo vite edhe kësaj radhe mbështet promovimin medial përmes botimit të Broshurës - gazetes " Gruaja në fokus ", në bashkëpunim me OJQ e grave "Shtjefan Gjeqovi " në të cilën promovohen projektet dhe aktivitetet e OJQ-ve, e në veçanti të femrave.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Graçanicës, në bashkëpunim me OSBE-në kanë shfaqur filmin "Ato ia kanë dalë, mundesh dhe ti" në sallën e Komunës, me rastin e shënimit të 8 Mars-it. Kanë marrur pjesë rreth 20 Gra. Lidhur me 16 ditët e aktivizmit për luftë kundër dhunës që bazohet në gjini, zyrtarja ka realizuar dy aktivitete.

- Takim me Komunitetin Rom, ligjerim për të drejtat e njeriut. Në takim kanë marrur pjesë 10 anëtarë të Komunitetit Rom nga organizata VORAE.
- Në bashkëpunim me OSBE-në është mbajtur ekspozita e vizatuar me temë "Paqe në Botë". Kanë marrur pjesë rreth 60 fëmijë nga Shkollat Filllore nga Graçanica dhe Kishnica.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë, në bashkëpunim me programin të USAID, kanë mbajtur takime informuese për ngitjen pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjimet buxhetore. Po ashtu janë realizu edhe disa aktivitete tjera si pjesëmarrje në mbledhjen e K.komunal Vushtri, Pjesëmarrja në mbledhjet e KKSB, si dhe shume aktivitete tjera.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Mamushës, në bashkëpunim me Grupin e Grave të kësaj Komune, ka shënuar 16 Ditët e Aktivizmit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas, ku ka mbajtur

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

një tryezë diskutimi mbi rëndësinë e kësaj dite.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës, ka realizuar një mori aktivitete, në bashkëpunim me Komunën ka implementuar projektin "Gruaja dhe Trashëgimia" në zonat rurale dhe Urbane, me qëllim të vetëdijimit për posedimin e trashëgimisë së përbashkët. Si dhe ka organizuar tryeze të rrumbullakët me rastin e shënimit të 16 Ditëve të Aktivizmit, me temë: "Sa respektohen të drejtat e njeriut-Parandalimi i dhunës në Baza Gjinore". Si dhe ka realizuar një broshurë me temë Trashëgimia është e jona.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, Pejë

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës konform përgjegjësi që ka shfrytëzon të gjithë mekanizmat e mundshëm për të krijuar mundësi për pjesëmarrje aktive të femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke u munduar të krijoj një klimë në të cilën atyre ju mundëson të japin kontributin e tyre në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Me iniciativën e ZBGJ dhe nën patronatin e Kryetares së Komunës, Mimoza Kusari Lila është organizuar panair dy ditor ku janë prezantuar punimet e grave si me ato me artizante dhe prodhimin e produkteve

ushqimore. Në hapje të këtij panairi ka marrë pjesë edhe kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari - Lila, e cila në paraqitjen e saj ka vlerësuar lartë kontributin e femrës përgjatë dekadave.

Në bashkëpunim me Asociacionin e përbashkët Dorsch & CDI është organizuar debat mbi temën "Gratë dhe Uji". Në këtë debat ka marrë pjesë edhe Kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila, e cila ka folur për rëndësinë që ka uji për jetën e njeriut duke shpalosur edhe investimet nga Komuna e Gjakovës që janë bërë për zgjerimin e rrjetit të ujit të pijes në zonat rural të Gjakovës. Në kuadër të rritjes së vizibilitetit të Mekanizmit Koordinues, si edhe ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta për ndërgjegjësimin e publikut, me mbështetjen edhe të UN Women Kosovë, UNCEF-it, OSBE-se, si dhe Komunës së Gjakovës janë shpërndarë materiale sensibilizuese, për fushatën ndërkombëtare të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. Krijimi i simbolit të fushatës, konkretisht formimi i fjongos me nxënësit e shkollave të mesme (shm. Gjymnazi "Hajdar Dushi" dhe shk. m. teknike-Nexhmedin Nixha"



Aktiviteti i ZBGJ në Gjakovë

Vizitoni Web faqen e ABGJ-së
<http://abgj.rks-gov.net/>

Mandati i Agjencisë për Barazi Gjinore

Qeveria e Kosovës me vendim nr. 5/131 të datës 1 shkurt 2005 ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore si organ të veçanët të Qeverisë së Kosovës konform nenit 5.1, Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr. 2004/2). Me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 03/2006 të datës 12.07.06 Zyra për Barazi Gjinore, prej 1 Shtatorit 2006 shndërrohet në Agjenci për Barazi Gjinore, në Zyrën e Kryeministrit.

Agjencia për Barazi Gjinore është organ i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë dhe të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë.

Adresa:

Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit,
Sheshi Skënderbe kati VII, Prishtinë, 10000
Tel: +381 38 200 14 276
Email: info.abgj@ks-gov.net

